

## **Kur mbaron Tranzicioni? Teoria kundrejt realitetit në Shqipëri**

Prof.Dr. Ermelinda Meksi<sup>1</sup>  
Auron PASHA<sup>2</sup>

### **Shënim**

*Bërja e një prezantimi me këtë titull nuk është një gjë e lehtë. Tema është mjaft e gjerë dhe ka të bëjë me çdo aspekt të reformave në periudha tranzicioni. Si e tillë është e pamundur të përfshih të gjitha këto aspekte në një prezantim të vetëm. Qëllimi i këtij prezantimi është hapja e një debati në këtë forum të shquar rreth pyetjes "Kur mbaron Tranzicioni ? Për këtë arsye do të përpiqemi të diskutojmë disa aspekte të reformave në tranzicion, duke adoptuar një kuadër të përcaktuar.*

### **A mund t'i përgjigjemi pyetjes?**

Një nga ekonomistët e shquar të kohrave tona, Joe Stiglitz, ka shkruar se kalimi nga regjimet socialiste në ekonomitë e tregut është një eksperiment i madh. Kjo nënkupton se diçka po vihet në provë. Me sa duket në këtë eksperiment ato që po vihen në provë janë pikërisht metodat dhe mënyrat për të marrë rezultatin, ndërkohë që rezultati njihet – një ekonomi tregu me zhvillim të plotë. Pra, debati qëndron pikërisht në mënyrat për ta arritur këtë rezultat. Mbas më shumë se një dekade ndryshimesh dhe reformash në vendet në tranzicion, një pyetje lind natyrshëm. Kur po i vjen fundi tranzicionit? Tranzicion-sikurse pohon edhe vetë emri, do të thotë se duhet t'i vijë fundi në një kohë të caktuar. A është akoma tranzicion apo zhvillim?

Shumë studiues kanë ngritur çështjen "Fundit i Tranzicionit" dhe janë munduar t'i japin disa përgjigje. Ndonjëherë përgjigjet e tyre vetëm sa e ngatërruan më tej faktin se, nga se përcaktohet saktësisht fundi i tranzicionit. Si matet përfundimi i tranzicionit? Janë bërë shumë përpjekje për të njehsuar treguesit, të cilët do të përcaktonin statusin e zhvillimit në tranzicion. Disa nga këta tregues janë cilësorë dhe disa të tjerë janë sasiorë. Përdorimi i këtyre treguesve është i rëndësishëm për të gjykuar rreth progresit dhe problemeve, por duhet të themi gjithashtu, se shpeshherë këta tregues nuk bëjnë gjë tjetër veçse konfirmojnë atë çka fare thjesht mund "të shihet pa ndihmën e një udhërrëfyese"<sup>3</sup>. Ndonjëherë tregues anektodikë mund të tregojnë shumë më mirë se ku ndodhet një vend. Një tregues i tillë, që përshtatet për kushtet e Shqipërisë, është kohëzgjatja e nevojshme për të kaluar nëpër sportelin/seksionin e imigracionit në aeroport.<sup>4</sup> Po ta përkthenim këtë tregues për qëllimin e këtij prezantimi mund të thonim se –

---

<sup>1</sup> Zëvendësministre dhe Ministre Shteti për Integrimin Evropian.


<sup>2</sup> Drejtori Ekzekutiv, Instituti i Zhvillimeve Kërkimore dhe Alternativave.

<sup>3</sup> Fshati që duket, s' do kallaus – Proverb shqiptar.

<sup>4</sup> Jak Bashkimi Evropian – Mbi (Pa)dobishmërinë e Treguesve të Qeverisjes – ABD 2002.

sa më e shkurtër kohëzgjatja, aq më afër fundit të tranzicionit është një vend. Dhe mund të thonim se kohëzgjatja kur kalon në sportelin e imigracionit në Rinas është shkurtuar në këto vitet e fundit.

**Reformat e fazës së parë** kanë të bëjnë me liberalizimin e çmimeve, me liberalizimin e tregtisë, me privatizimin e shkallës së ulët dhe me vendosjen e ligjeve kyçe të tregtisë. **Në fazën e dytë**<sup>5</sup> reformat janë disi më të komplikuar. Privatizimi i një shkalle të lartë, ristrukturimi i ndërmarrjeve, politika e konkurrencës, reformat e sektorit financiar (duke përfshirë tregjet bankare dhe kapitale), infrastruktura si dhe efektiviteti i ligjeve kryesore tregtare. Ideja e këtyre treguesve është të matin progresin e reformave si edhe mënyrën që mund të krahasohet me pikën e referimit (**benchmark-un**) të ekonomisë së tregut.



<sup>5</sup> Është e pranueshme nga të gjithë se faza e dytë është më problematike, sepse kapaciteti institucional i kërkuar për zbatimin e këtyre reformave është shumë më i lartë se për fazën e parë. Faza e dytë e reformave faktikisht ka të bëjë me krijimin e kapacitetit të qeverive për të qeverisur. Megjithatë, me sa duket diçka që nuk është thënë shpesh në të kaluarën po përmendet tani. Dhe kjo është – **mënyra sesi reformat u zbatuan në fazën e parë (ndonëse mund të jetë thujtë e përfunduar) pati ndikim në zbatimin e reformave të fazës së dytë. Këto reforma ose u përshpejtuan ose u vonuan.**

**Shënime shpjeguese për grafikun.**

Marrë nga "Vëzhgim mbi Progresin e Vendeve" – USAID- E dhe E.

Renditjet e lirive demokratike janë marrë nga Freedom House, Nations in Transit (2002), dhe përfshin ngjarje deri në 31 dhjetor 2001. Renditjet e reformave të politikave ekonomike janë marrë nga BERZH, Raporti i Tranzicionit 2001 (Nëntor 2001), dhe mbulon ngjarjet deri në shtator 2001. Reformat e politikave ekonomike përfshijnë liberalizimin e çmimeve, tregtinë dhe shkëmbimet me jashtë, privatizimin, kuadrin juridik, tregjet bankare dhe ato të kapitalit, ristrukturimin e sipërmarrjeve (politikën e kreditimit dhe të subvencionimit), dhe reformat në infrastrukturë. Liritë demokratike përfshijnë: të drejtat politike (zgjedhje të lira dhe të ndershme, qeverisje dhe administrim publik) dhe liritë e qytetarit (media dhe gjyqësor i lirë, liri për zhvillimin e OJQ-ve dhe të sindikatave, barazi në mundësitë dhe liri ndaj korrupsionit). Renditjet janë bazuar në një shkallë nga 1 në 5, ku 5 përfaqëson më të avancuarit.

Freedom House përdor, gjithashtu, edhe një skemë tjetër për tre përmasat e reformave ekonomike në vendet në tranzicion (Privatizimi, reformat makroekonomike dhe reformat mikroekonomike).

		Privatizim		Ref Makro.		Ref Mikro.		Mes.*
		1998	2002	1998	2002	1998	2002	
1.	Polonia	2.25	2.25	1.75	2.0	1.75	1.5	1.92
2.	Estonia	2.0	1.75	2.0	2.0	2.0	2.0	1.92
3.	Hungaria	1.5	1.5	1.75	2.5	1.75	2.0	2.00
4.	Rep. Çeke	2.0	1.75	2.0	2.25	2.0	2.25	2.08
5.	Sllovenia	2.5	2.5	2.0	2.0	2.0	2.0	2.17
6.	Letonia	2.5	2.5	2.5	2.25	2.5	2.25	2.33
7.	Sllovakia	3.25	2.0	3.75	2.5	3.75	2.5	2.33
8.	Lituania	2.25	2.25	2.75	2.75	2.75	2.25	2.42
9.	Bullgaria	4.0	3.0	4.0	3.0	4.25	3.75	3.25
10.	Kroacia	4.0	3.25	3.75	3.5	3.75	3.75	3.50
11.	Armenia	3.75	3.25	4.25	3.5	4.25	4.0	3.58
12.	Kirgistani	4.25	4.25	3.5	3.5	3.5	3.5	3.75
13.	Shqipëria	4.0	3.25	5.0	4.0	4.5	4.0	3.75
14.	Gjeorgia	4.0	3.25	4.0	4.0	4.0	4.0	3.75
15.	Rumania	4.5	3.75	4.5	3.75	4.5	4.25	3.92
16.	Rusia	3.0	3.5	4.25	3.75	4.25	4.5	3.92
17.	Moldavia	4.0	4.0	4.25	4.5	4.25	4.25	4.25
18.	Kazakistani	4.25	4.0	4.5	4.25	4.75	4.5	4.25
19.	Ukraina	4.5	4.25	4.5	4.5	5.25	4.5	4.42
20.	Azerbaixhani	5.0	4.25	5.0	4.5	5.0	4.5	4.42
21.	Maqedonia	4.0	4.25	5.0	4.75	5.0	5.0	4.67
22.	Serbi/Mal i Zi	4.5	4.75	5.0	5.25	5.0	5.0	5.0
23.	Taxhikistani	6.25	5.5	6.0	5.5	5.75	5.25	5.08
24.	Bosnje- Herzegovina	5.5	5.0	6.0	5.5	6.0	5.5	5.33
25.	UzBashkimi Evropiankistan	6.25	6.0	6.25	6.0	6.25	6.0	6.0
26.	Bjellorusia	6.0	6.0	6.25	6.25	6.5	6.5	6.25
27.	Turkmenistani	6.75	6.75	6.25	6.25	6.25	6.5	6.5

Burimi: renditjet janë bazuar në sistemin normal Freedom House, ku në mënyrë thelbësore 1= "progress" maksimum dhe 7= asnjë progres.

Ka, gjithashtu, edhe modele të njohura që përpiqen të matin kohën që vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore iu duhet për të arritur nivelet e

zhvillimit të vendeve të Evropës Perëndimore duke përdorur një metodë **standarde regresi për rritjen**, sipas të cilës rritja e PBB-së varet nga faktorë që janë të lidhur ngushtë me rritjen ekonomike, faktorë këta që janë nxjerrë nga një numër studimesh nëpër vende të ndryshme (për shembull, regjistrimi në shkollë, raporti i investimeve ndaj PBB-së, PPB-ja fillestare)<sup>6</sup>. Megjithatë, sikurse është vënë në dukje, me të drejtë, nga shumë studiues, këto modele supozojnë se ekonomitë me treg të zhvilluar dhe ekonomitë në tranzicion reagojnë njëllë ndaj sinjaleve (kjo nënkupton se tregjet kanë të njëjtën strukturë). Dhe faktikisht, kjo është dhe çështja që ka të bëjë me fundin e tranzicionit.

Të tjerë vlerësojnë "lagesën" e vendeve të ish-Bashkimit Sovietik (CEEC) nga ekonomitë e tregut të vendeve perëndimore duke iu referuar variablave makroekonomikë të tillë, si inflacioni dhe deficitet buxhetor. Gjithësesi, nuk janë këta tregues ata që karakterizojnë qartë një ekonomi tregu. Të tjerë studiues analizojnë ndryshimin ndërmjet vendeve të ish-Bashkimit Sovietik (CEEC) dhe atyre anëtare në Bashkimin Evropian duke mbajtur parasysh më shumë tregues të tjerë themelorë siç është infrastruktura.

**Për t'iu përgjigjur pyetjes: "A ka mbaruar tranzicioni?", ndoshta do të na duhet t'i përgjigjemi pyetjes: A ka lënë ekonomia e centralizuar e planit, e pushtetit komunist një trashëgimi, që edhe mbas një dekade ndryshimesh, ekonomitë komuniste (në këtë rast Shqipëria) dallohen nga vendet e tjera të botës me një të ardhur për frymë të krahasueshme?" (M.Suhrcke).**

### **Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian: Matja se kur po i vjen fundi.**

Do të mundohemi të trajtojmë problemin "fondi i tranzicionit" duke adoptuar një kuadër të caktuar. Dhe në këtë rast një kuadër i tillë duket se është procesi i integritimit në Bashkimin Evropian. Përgjigja e pyetjes "Kur mbaron tranzicioni?" do të ishte – Kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian. Duket e lehtë por nuk jep asnjë detaj mbi procesin. Më poshtë do të shtjellojmë se çfarë do të thotë kjo për Shqipërinë.

Përpara se të fillojmë me detajet e procesit, duhet të sqarojmë një çështje. A shënon hyrja e Shqipërisë në Bashkimin Evropian fundin e tranzicionit? Sipas këndvështrimit teorik, një vend mund të ketë ekonomi tregu dhe megjithatë mund të mos jetë anëtar i Bashkimit Evropian. Kështu, fundi i tranzicionit mund të jetë më i shpejtë se sa pranimi, por e rëndësishme është se me t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian, kjo pyetje nuk ka më rëndësi. Një vend që

<sup>6</sup> Marc Suhrcke. (intereconomics )

është anëtar i Bashkimit Evropian zor se mund të ketë akoma një ekonomi në tranzicion.

Kandidatët për pranimin në Bashkimin Evropian duhet të përmbushin ato çka njihen si "Kriteret e Kopenhagenit", që përfshijnë kriteret e mëposhtme:

- **Politike** – arritja e stabilitetit të institucioneve që garantojnë demokracinë, pushtetin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e minoriteteve.
- **Ekonomike** – ekzistenca e një ekonomie tregu që funksionon, dhe aftësia për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.
- **Administrative** – aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë, përfshirë edhe besnikërinë ndaj tendencës për bashkime politike, ekonomike dhe monetare.

Në funksion të këtij prezantimi, do t'i grupojmë këto kritere në dy grupe: ekonomike dhe të qeverisjes (politike dhe administrative).

## **KRITERE EKONOMIKE.**

Çdo të thotë të kesh një ekonomi tregu që funksionon? Sipas, këtyre kritereve, sikurse është përcaktuar në Agenda 2000, ekzistenca e një ekonomie tregu që funksionon kërkon liberalizimin e çmimeve dhe të tregtisë, si edhe një sistem ligjor të imponueshëm, përfshirë këtu edhe të drejtën mbi pronën. Ecuria e një ekonomie tregu forcohet nga konsensusi midis politikave ekonomike dhe stabilitetit makroekonomik. Një sektor financiar i zhvilluar mirë dhe mungesa e çdo pengese të rëndësishme ndaj hyrjes dhe daljes nga tregu, përmirësojnë efikasitetin e ekonomisë.

- **Liberalizimi i çmimeve** – Shqipëria ka arritur një shkallë të lartë të liberalizimit. Të vetmet çështje për t'u përfshirë në këtë fushë janë ato të lidhura me numrin e produkteve të infrastrukturës së shërbimeve komunale të tilla si energjia, uji, telekomunikacioni etj.. Disa nga këto çmime po decentralizohen (si uji), por liberalizimi i plotë i çmimeve të shërbimeve komunale ka nevojë për një trajtim të kujdesshëm.
- **Liberalizimi i tregtisë** - Shqipëria është tashmë anëtare e OBT-së, çka sugjeron se liberalizimi i tregtisë është "provim i kaluar" si çështje. Megjithatë, liberalizimi i tregtisë ka si objektiv sigurimin e një baze të fortë për më shumë rritje ekonomike, e nxitur nga rritja e eksporteve.

Kur liberalizimi i tregtisë nuk ndiqet nga oferta e eksporteve, nuk do të thotë se ai nuk është i efektshëm. Shpeshherë, kjo nënkupton se liberalizimi i tregtisë është zbatuar vetëm pjesërisht. (Veprimet për nxitjen e eksporteve,

shpeshherë mungojnë ose janë të kufizuara.) Tashmë puna në këtë drejtim ka filluar.

Gjithashtu, liberalizimi i tregtisë e detyron ekonominë të përqendrohet në sektorë më potencialë konkurrues. Nga këndvështrimi i pyetjes të shtruar në fillimin të këtij prezantimi, mund të themi gjithashtu, se një ekonomi ku organizimi i prodhimit nuk ka arritur ende ekuilibrin afatgjatë të tregut, është ende në tranzicion. (*Annette N. Brown, 1999.*) Kjo s'do të thotë se organizimi i prodhimit nuk ndryshon më, por se struktura e prodhimit ndryshon ngadalë me zhvillimin e ekonomisë. **Një ekonomi është akoma në tranzicion kur industritë janë ende duke u reformuar ndjeshëm.** Shenjat e konsolidimit të strukturës janë vënë re këto vitet e fundit, por ka akoma rrugë për të bërë.

- **Stabiliteti makroekonomik.**

Shqipëria ka arritur një fazë të kënaqshme të stabilitetit makroekonomik. Ecuria e rritjes ka qenë e qëndrueshme gjatë viteve të fundit. (Megjithatë, duhet thënë se llogaritjet e rritjes nuk janë shumë të besueshme duke qenë se nuk ka ende të dhëna kombëtare zyrtare, dhe llogaritjet zyrtare të rritjes përfshijnë në mënyrë jo të saktë sektorin privat dhe atë jozyrtar.) Në mënyrë të veçantë, inflacioni ka rënë dhe arriti në fund të vitit 2002 në 2,1 për qind. (Inflacioni mesatar për vitin 2002 ishte 5,4 për qind<sup>7</sup>.) Çështja këtu është sesa i qëndrueshëm është stabiliteti makroekonomik. Në këtë aspekt ka disa sfida. Problemi i energjisë duket të jetë një tjetër çështje problematike që pengon rritjen e qëndrueshme. Efektet e para të krizës energjitike u panë në ritmet më të ulëta të rritjes për vitin 2002. Me sa duket, ka patur përmirësime në këtë fushë, por megjithatë, problemi mbetet akoma pa një zgjidhje të plotë. Niveli i ulët i investimeve, dërgesat nga jashtë dhe mbështetjet financiare të huaja karakterizuar këto nga një tendencë në rënie, janë të tjerë faktorë sfidues. Nga ana tjetër, niveli i PBB-së për frymë mbetet ai më i ulëti në rajon (duke arritur nivelin e 1521 dollarë për frymë në vitin 2002). Të gjitha këto janë **çështje për t'u përballur në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.**

- **Të drejtat mbi pronën.**

Të drejtat mbi pronën, që zbatohen si duhet, janë elementet kyçe në një ekonomi tregu që funksionon. Përforcimi i të drejtave mbi pronën mbetet ende i vështirë në Shqipëri. Ndonëse ka përmirësim në reformat ligjore, sërish besimi i njerëzve në sistemin ligjor, si garanci për zbatimin e tij, është i dobët. Të drejtat mbi pronën intelektuale fatkeqësisht janë ende shumë të panjohura në Shqipëri. Problemet kanë të bëjnë me legjislacionin, por si gjithmonë edhe me zbatimin e tij. Me sa duket, tregu i përcaktuar më qartë është tregu i strehimit, ndonëse edhe këtu ka akoma probleme me zyrat e regjistrimit. Pavarësisht, ky treg duket se po ecën mirë. Ndërsa tregu i tokës është diçka që kërkon akoma ndërhyrje. Ky treg nuk po funksionon si duhet, veçanërisht ai i lidhur me tokën bujqësore, sepse të drejtat mbi pronën nuk janë përcaktuar si duhet, ende. Procesi i kthimit apo i kompensimit nuk ka

---

<sup>7</sup> Sipas Raportit Vjetor 2002 të Bankës së Shqipërisë.

mbaruar, dhe deri sa të përfundojë, ky treg do të qëndrojë në vend. Sistemi i regjistrimit të tokës akoma nuk është finalizuar. Ky përbën një pengesë serioze në rritjen e produktivitetit në bujqësi.

- **Privatizimi.**

Shqipëria konsiderohet si një vend që ka kryer privatizime në nivele të ulëta. Sfida për momentin është vazhdimi i procesit të privatizimit strategjik me AlbTelekom, me INSIG-un dhe me Bankën e Kursimeve, me Industrinë e Naftës, me sektorin energjitik, me ujësjellësim etj.. Ekziston akoma një çështje pezull, që lidhet me programin e privatizimit masiv, si dhe me skemën e garantimit. Kjo skemë mund të konsiderohet një dështim<sup>8</sup> dhe kjo çështje mbetet ende e pazgjidhur. (Këtu mund të përmendim parrullën e institucioneve ndërkombëtare financiare për privatizimin e ndërmarrjeve – “vlerën e vendos tregu” ndërkohë që TREGU NUK FUNSIONONTE si duhet).

- **Zhvillimi i sektorit financiar.**

Sektori bankar mund të themi se është zhvilluar gjatë viteve të fundit. Megjithatë, zhvillimi ka qenë kryesisht në terma sasiorë. Është e lehtë të kesh banka të sigurta, banka që nuk i humbasin paratë për shkak të huave të këqija – për këtë mjafton që ato të investojnë në bonot e thesarit. Sfida nuk është vetëm të krijosh banka të sigurta, por banka të sigurta që sigurojnë kredi për rritje ekonomike.

Kredia për ekonominë vitin e kaluar në Shqipëri ishte vetëm 7,2 për qind e PBB-së, kundrejt mesatares prej 40 për qind që është në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore.<sup>9</sup>

Në një studim interesant të BERZH-it, përgatitur nga Steven Fries dhe Anita Taçi, është llogaritur raporti i totalit të sektorit privat ndaj PBB-së si dhe pika e referimit (*benchmark*-u) të ekonomisë së tregut, që nënkupton këtë raport për një vend me ekonomi tregu dhe me nivele të ngjashme zhvillimi të matura nga PKB për frymë (me bazë PPP)<sup>10</sup>.

	1994			1999		
	Totali i kredisë së sektorit privat ndaj PBB-së	Benchmark-u i ekonomisë së tregut	Largësia nga Benchmark-u	Totali i kredisë së sektorit privat ndaj PBB-së	Benchmark-u i ekonomisë së tregut	Largësia nga Benchmark-u
Kroacia	31.5	39.4	7.9	38.5	46.9	8.4
Republika Çeke	76.6	58.1	-18.5	61.4	63.5	2.1
Estonia	15.4	39.5	24.1	35.8	48.7	12.9
Hungaria	26.2	49.6	23.4	25.7	56.8	31.1
Letonia	18.4	35.6	17.2	16.5	42	25.5
Lituania	20	36.7	16.7	13.9	43.8	29.9

<sup>8</sup> Ky proces nuk ishte i suksesshëm as në vendet e ish-Bashkimit Sovietik, ku parametrat e tregut ishin më të zhvilluar.

<sup>9</sup> Sipas Raportit Vjetor 2002, të Bankës së Shqipërisë.

<sup>10</sup> Autorët kanë llogaritur *benchmark*-un e ekonomisë së tregut duke u bazuar në një model regresioni jolinear të PKB për frymë (\$PPP) me raportin e sektorit privat ndaj PBB-së për 122 vende në zhvillim dhe të industrializuara.

Polonia	18.6	44.9	26.3	28.8	54.2	25.4
Sllovakia	43.3	49.4	6.1	56.5	58.1	1.6
Sllovenia	23.3	61.1	37.8	37	69.1	32.1
<b>Shqipëria</b>	<b>5.7</b>	<b>25</b>	<b>19.3</b>	<b>3.9</b>	<b>30.7</b>	<b>26.8</b>
Bullgaria	49.3	41.7	-7.6	17.9	42.1	24.2
Maqedonia	45.3	34.2	-11.1	22.7	36.2	13.5
Rumania	19.1	38.9	19.8	10.7	40.4	29.7

*Burimi: Studimi " Reforma Bankare dhe Zhvillimi në Ekonomitë në Tranzicion" nga S. Fries and Anita Taçi.*

## **Politika e konkurrencës.**

Përfitimet nga zhvillimi i sektorit privat janë të lidhura me përmirësimin e efikasitetit të shpërndarjes dhe të produktivitetit. Në këtë kontekst, reformat ekonomike si liberalizimi i tregtisë dhe i tregut financiar, privatizimi etj., janë parë gjithmonë si mjete për të nxitur konkurrencën dhe për të promovuar një efikasitet më të madh.

Politika e konkurrencës është shumë më tepër se vetëm legjislacioni i konkurrencës. Politika e konkurrencës është një set me masa dhe me instrumente ku përfshihen edhe privatizimi, ristrukturimi, parregullsia, liberalizimi, investimet e huaja direkte.

Ndonëse janë bërë përpjekje kohët e fundit në përgatitjen e legjislacionit për konkurrencën, në harmoni me legjislacionin evropian të kësaj fushe (ligji i ri "Për mbrojtjen e konkurrencës" u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë më 28 korrik 2003), forcimi i politikës së konkurrencës në Shqipëri ka ende nevojë për përmirësim. Ligji i ri hedh themelet për vendosjen e një Autoriteti të Pavarur të Konkurrencës. Aktualisht, objektivi kryesor është bërja e kësaj strukture plotësisht funksionale dhe operacionale. (Bashkërendimi i kësaj strukture me autoritetet e tjera rregullatore është mëse i domosdoshëm për prezantimin e politikave të reja, pro-konkurrencës, në sektorët e rregulluar).

Hyrja në treg është përmirësuar ndjeshëm, por akoma paraqiten probleme të tilla si procedurat e licencimit apo pengesa të tjera administrative, që duhen shqyrtuar. Ndërkohë, dalja nga tregu nuk po funksionon si duhet. Vetëm një numër i papërfillshëm firmash kanë deklaruar falimentimin, ndonëse vitin e kaluar është miratuar një ligj sipas standardeve ndërkombëtare "Mbi falimentimin". Procedurat e paaftësisë paguese duhen përmirësuar, ndërsa sistemi juridik duhet të trajtojë seriozisht problemet në këtë fushë.

Një tjetër çështje e lidhur me konkurrencën është ekonomia informale. Kjo çështje është shumë komplekse dhe nuk mund të shikohet vetëm nga një këndvështrim. Në të gjithë jemi dakord se informaliteti ka pasoja negative në zhvillimin e sektorit privat formal, po t'i referohemi konkurrencës. Nga ana tjetër, informaliteti në ekonomi është një matës përfaqësues i efikasitetit të strukturave të shtetit. Ndonëse na mungojnë të dhënat për matjen e

ekonomisë informale (më mirë të themi se na mungon konsensusi për një metodologji) shifrat nga institucione të ndryshme tregojnë se ekonomia informale është rreth 30 për qind (INSTAT) në 60 për qind (vlerësime nga institucione financiare ndërkombëtare). Duket qartë se kjo është një sfidë që duhet të përballohet në të ardhmen.

## **KRITERET E QEVERISJES.**

Reformat efektive ekonomike janë të lidhura ngushtë me një qeverisje të mirë. Janë ngritur shumë tregues mbi çështje të qeverisjes. Megjithatë, mund të themi se efikasiteti i institucioneve të shtetit nuk matet lehtë.

Për të ilustruar çështjen e qeverisjes në Shqipëri, do të donim të paraqisnim, në këtë material, disa tregues të qeverisjes që u analizuan në një projekt kërkimor<sup>11</sup> (ku është përfshirë edhe Shqipëria) nga Daniel Kaufmann, Aart Kraay dhe Pablo Zoido-Lobaton. Materiali i studimit të tyre kishte për qëllim krijimin e indekseve agregate të qeverisjes, duke u bazuar në gjashtë koncepte të gjera të qeverisjes<sup>12</sup>, të ndara në tre grupe.

Grupi parë i treguesve agregatë synon të masë procesin sipas të cilit përzgjidhen dhe zëvendësohen autoritetet. Ai përfshin dy grupe:


- 1. "Votat dhe përgjegjësia"**<sup>13</sup>. Ky tregues përfshin një numër nëntreguesish që masin aspekte të ndryshme të procesit politik, të lirive të qytetarit dhe të të drejtave politike. Të gjithë këta tregues matin nivelin sipas të cilit shtetasit e një vendi mund të marrin pjesë në zgjedhjen e qeverive. Në këtë kategori përfshihen, gjithashtu, edhe tregues që matin pavarësinë e mediave, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e autoriteteve në pushtet dhe në vënien përpara përgjegjësive për veprimet e tyre.

---

<sup>11</sup> "Governance Matters II: Updated Indicators for 2000/01".


<sup>12</sup> Të gjashta indekset janë matur me njësi që variojnë nga -2.5 në 2.5, ku -2.5 është një nivel shumë i ulët i indeksit dhe 2.5 është një nivel shumë i lartë. Megjithatë, duhet thënë se marzhi (diferenca) i gabimit të indekseve është relativisht i madh dhe kjo tregohet në grafikët me viza vertikale. Këto indekse janë akoma subjekt i kërkimeve si dhe i përmirësimeve të mëtejshme. Por, megjithatë ato tregojnë një tendencë që është e vlefshme për vlerësimin e politikave dhe të reformave të ndryshme në një vend të caktuar.

<sup>13</sup> Grafikët janë ndërtuar me një plan interaktiv të dhënash.



Burimi: "Governance Matters II: updated Indicators for 2000-01" nga Daniel Kaufmann, Aart Kraay dhe Pablo Zoido-Lobaton, Jan 2002.


**2. "Stabiliteti politik".** Në këtë indeks janë kombinuar tregues të ndryshëm, të cilët matin ndjesinë e gjasës (probabilitetit) që një qeveri në pushtet do të destabilizohet ose do të rrëzohet me mjete të dhunshme apo jokushtetuese. Ky indeks nënvizon idenë se cilësia e qeverisjes në vend, kompromentohet (rrezikohet) nga gjasa (probabiliteti) të ndryshimit me dhunë të qeverisjes, të cilat kanë jo vetëm një efekt të drejtpërdrejtë në vazhdimësinë e politikave, por edhe më shumë vënë në rrezik aftësinë e të gjithë shtetasve për të zgjedhur dhe për të ndërruar paqesisht një qeveri.



Source: "Governance Matters II: updated Indicators for 2000-01" by Daniel Kaufmann, Aart Kraay and Pablo Zoido-Lobaton, Jan 2002.

Grupi i dytë i indekseve përbëhet nga disa tregues, të cilët matin aftësinë e qeverisë për të formuluar dhe për të zbatuar politika të shëndosha dhe efektive.


- 3. "Efikasiteti i qeverisë".** Në këtë indeks kombinohen perceptimet për cilësinë e dispozitave të shërbimeve publike, për cilësinë e burokracisë, kompetenca e nëpunësve civilë, pavarësia e shërbimit civil nga presionet politike si dhe besueshmëria e angazhimit të qeverisë ndaj politikave në një grupim të vetëm.
- 4. "Cilësia rregullatore".** Fokusohet më shumë në vetë politikat. Ajo përfshin matjen e peshës që zënë politikat jomiqësore të tregut, si për shembull kontrolli mbi çmimet, mbikëqyrja bankare jo e përshtatshme si edhe ndjesitë e ngarkesave të vëna nga rregulloret të tepërta, në fusha si tregtia me jashtë dhe zhvillimi i biznesit.



Burimi: "Governance Matters II: updated indicators for 2000-01", Daniel Kaufmann, Aart Kraay dhe Pablo Zoido-Lobaton, Jan. 2002.

Grupi i fundit përmbledh në terma të përgjithshëm respektin e shtetasve dhe të shtetit për institucionet që drejtojnë ndërveprimet e tyre.


**5. Sundimi i ligjit.** Në këtë indeks janë përfshirë disa faktorë të cilët matin masën e besimit dhe të bindjes për rregullat e shoqërisë. Këtu



Burimi: "Governance Matters II: updated Indicators for 2000-01 " by Daniel Kaufmann, Aart Kraay dhe Pablo Zoido-Lobaton, Jan 2002.

*përfshihen ndjesi (perceptimi) për shkallën e (madhësisë, nivelit, peshës) veprimit si të krimit të dhunshëm ashtu edhe të atij jo të dhunshëm, për efektivitetin e gjyqësorit, për aftësinë parashikuese të tij si dhe për aftësinë për të imponuar zbatimin e kontratave. Në një fjali të vetme, ky indeks reflekton faktin sesa e suksesshme është një shoqëri në krijimin e një ambienti, në të cilin rregullat e ndershëm dhe të parashikueshëm të saj formojnë bazën e ndërveprimit ekonomik dhe shoqëror.*

**6. Kontrolli ndaj korrupsionit.** Ky indeks mat perceptimin mbi korrupsionin, që në mënyrë konvencionale përkufizohet si përdorimi i autoritetit publik për përfitime private. Korrupsioni manifeston një mungesë respekti si nga ata që korruptojnë ashtu edhe nga ata që korruptohen kundrejt ligjit dhe rregullave, duke përfaqësuar në këtë mënyrë dështim në qeverisje.



Ndjeshmëria kundrejt realitetit.

Në çështjen "fundi i tranzicionit" nuk mund të neglizhojmë faktorin e ndjeshmërisë. Sa të ndjeshëm jemi ndaj progresit të reformave? Ndjeshmëria ndryshon më ngadalë se realiteti. Shembulli më i mirë që do të donim të sillnim këtu është indeksi i lirisë ekonomike nga treguesit e fondacionit "Heritage" /Gazeta "Wall Street". Indeksi mat renditjen e 161 vendeve në një listë me 50 variabla të pavarur, të ndarë në 10 faktorë të përgjithshëm të lirisë ekonomike. Sa më të larta pikët në një faktor, aq më i madh është niveli i ndërhyrjes qeveritare në ekonomi dhe aq më e ulët liria ekonomike që gëzon një vend. Këta 50 variabla grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Politika e tregtisë.
- Ngarkesa fiskale e qeverisë.
- Ndërhyrja e qeverisë në ekonomi.
- Politika monetare.
- Fluksi i kapitalit dhe investimet e huaja.
- Bankat dhe financa.
- Pagat dhe çmimet.
- Çmimet e pasurisë.
- Rregulloret.
- Tregu i zi (2003).

Secili faktor llogaritet sipas një shkalle klasifikuese që është e vetme për atë (secilin) faktor. Shkallët variojnë nga 1 në 5: pika 1 nënkupton një set institucional apo të qëndrueshëm politikash, që janë mëse të favorshme për lirinë ekonomike, ndërsa pika 5 nënkupton një set politikash që nuk janë të favorshme. Katër kategoritë e lirisë ekonomike në indeks janë:

- **Të lira** – vendet me rezultat mesatar të përgjithshëm 1.95 ose më pak.
- **Mëse të lira** – vendet me rezultat mesatar të përgjithshëm 2.00 deri në 2.95.
- **Mëse jo të lira** – vendet me rezultat mesatar të përgjithshëm 3.00 deri në 3.95.
- **Të shtypura** – vendet me rezultat mesatar të përgjithshëm 4.00 apo më lart.

<b>Faktorë individualë</b>	<b>Pikët</b>
Politika e tregtisë	5
Ngarkesa fiskale e qeverisë	3.5
Ndërhyrja e qeverisë	3
Politika monetare	2
Investimet e huaja	2
Bankat dhe financa	3
Pagat dhe çmimet	2
Të drejtat mbi pronën	4
Rregullacioni	4
Tregu i zi	5

Duke marrë parasysh faktin se me iniciativën e Qeverisë së Bushit mbi llogaritjen e sfidave të mijëvjeçarit, ky indeks do të jetë një nga masat për të vendosur se si po ecën një vend në zbatimin e reformave, atëherë ky është me të vërtetë një faktor i rëndësishëm. Shumica e treguesve këtu duken tepër të saktë, por gjithësesi ne kemi rezervat tona për disa prej tyre – sidomos për treguesit që iu

referohen politikave tregtare. Sipas indeksit, politika e tregtisë në Shqipëri renditet në shkallën 5, që do të thotë – nivel i lartë protektonizmi. Matja bazohet kryesisht në çmimet mesatare të tarifave duke i shtuar edhe vlerësimin mbi çmimet jotarifore. Përfundimi i këtij indeksi është i gabuar po të bazohemi në këtë metodologji. Shqipëria është anëtare e OBT-së dhe si e tillë ajo i nënshtrohet rregullave të tarifave që kjo organizatë vendos mbi anëtarët e saj. Gjithashtu, bazuar në metodologjinë dhe në të dhënat, rregullat mesatare të tarifave për vitet 2000 dhe 2001 janë përkatësisht 10, 4 për qind dhe 7,87 për qind<sup>14</sup>. Rrjedhimisht, Shqipëria duhet të arrijë një rezultat prej 3 pikësh për vitin 2000 (niveli i mesatar) dhe 2 pikësh për vitin 2001 (pengesa të ulëta). Nëse do të llogaritnim bilancin e tregëtisë kombëtare, atëherë maksimumi i pikëve që Shqipëria do të merrte për vitin 2001 është 3.

Ky është thjesht një shembull për të treguar se ndonjëherë treguesit nuk janë të saktë dhe se ata kanë pasoja në ndjeshmërinë ndaj progresit të një vendi.

## **Përfundim**

Ky prezantim nuk ishte thjesht një listë e lodhshme e të gjitha veprimeve që Shqipëria duhet të ndërmarrë për t'i dhënë "fund tranzicionit." Por, ai ishte një vështrim mbi reformat kryesore bazuar në një kuadër, që sipas mendimit tonë i përshtatet më së miri

<sup>14</sup> INSTAT – Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

qëllimeve të Shqipërisë për të ardhmen. Objektivi i këtij prezantimi ishte paraqitja e procesit të integrimit si një "proces matës" i progresit të reformave që përcaktojnë fazën e një vendi në tranzicion.

Duke iu kthyer pyetjes se kur mbaron tranzicioni, ne besojmë që përgjigja duhet të jetë – ATËHERË KUR SHQIPËRIA TË JETË PJESË E BASHKIMIT EVROPIAN. Çështja nuk është se ajo përcakton fundin e tranzicionit, por me t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian, çështja e "përfundimit të tranzicionit" nuk do të ketë më rëndësi. Një vend mund të ketë ekonomi tregu dhe mund të mos jetë anëtar i Bashkimit Evropian, por një anëtar i Bashkimit Evropian ka pa dyshim një ekonomi tregu.

Çështja e fundit të tranzicionit duhet lidhur me faktin nëse e kaluara socialiste ka lënë ende trashëgimi, që e bëjnë Shqipërinë të jetë ndryshe nga vendet e tjera me të ardhura të krahasueshme për frymë. Nëse do t'i ndanim faktorët në dy grupe (ekonomikë dhe qeverisës), është e qartë se ka ende reforma të papërfunduara në të dyja fushat. Përfundimi i tyre është i lidhur ngushtë me progresin drejt integrimit evropian.

## Bibliografi

1. *Index of Economic Freedom 2003 – Heritage Foundation and Wall Street Journal.*
2. *Monitoring Country Progress – USAID/E&E.*
3. *EBRD Transition reports.*
4. *Handbook on Development Policy and Management – C. Kirkpatric, R. Clarke, Ch. Polidano, 2002.*
5. *Economic Survey of Europe – tremujori i parë.*
6. *Determinants of Growth – Albanian Case- studim i IDRA-s, viti 2001.*
7. *Economics of Transition- from Socialist regime to market economy – Norman Graham.*
8. *Intereconomics – Mrach Suhrcke – Is Transition over?*
9. *Governance Maters II – Updated indicators 2000/2001, D. Kaufmann, A. Kraay, P. Zoido Lobaton, 2002.*
10. *Banka e Shqipërisë - Raporte Vjetore.*